

VENDIM
Nr. 218, datë 20.3.2013

PËR MIRATIMIN E KUFIJVE DHE KRITEREVE TË PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË TË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin vjetor të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme krijohet fondi rezervë, për të garantuar shpenzimet që rrjedhin nga dëmshpërblimet për dëmet e shkaktuara si rezultat i regjistrimit të një informacioni jo të rregullt mbi një pasuri të paluajtshme.

2. Masa e fondit rezervë përcaktohet jo më pak se 2 për qind dhe jo më shumë se 5 për qind e totalit të të ardhurave vjetore të parashikuara.

3. Masa e fondit rezervë miratohet me vendim të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pas propozimit të kryeregjistruesit.

4. Përdorimi i fondit rezervë bëhet kur shpenzimet e miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor janë përdorur dhe/ose janë të pamjaftueshme, në bazë të:

i) vendimit të kryeregjistruesit, për miratimin e vendimit të veçantë të regjistruesit për të drejtën e dëmshpërblimit, sipas kërkesës së palës së interesuar, i cili duhet të jetë në pajtim me dispozitat e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe sipas rregullave të përcaktuara nga bordi drejtues, për llogaritjen e dëmshpërblimit për dëmet e shkaktuara, si rezultat i regjistrimit të një informacioni jo të rregullt mbi një pasuri të paluajtshme; ose

ii) të një titulli ekzekutiv, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile, me objekt dëmshpërblimin, sipas parashikimeve të neneve 65, 66 dhe 67 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

5. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha